



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 240/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rustem Thaqi dhe Ferki Xhaferi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur lidhur me ankesat e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, të paraqitura ndaj subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 07.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohen të pabazuara ankesat: Anr.240/2019, Anr.253/2019, Anr.254/2019, Anr.258/2019, Anr.263/2019, Anr.272/2019, dhe Anr.274/2019, të gjitha të datës 05.10.2019, të paraqitura nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, për shkak të vazhdimit të sponsorimit të fushatës zgjedhore në rrjetin social “Facebook”, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore.

A r s y e t i m

Organizata Joqeveritare BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA kanë paraqitur në PZAP, ankesat: Anr.240/2019, Anr.253/2019, Anr.254/2019, Anr.258/2019, Anr.263/2019, Anr.272/2019, dhe Anr.274/2019, të gjitha me datë 05.10.2019, kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilat ka pretenduar, se me datë 05.10.2019, kandidatët për deputet të paraqitur në ankesat e lartcekura, kanë vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore në rrjetin social “Facebook”, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore. Më këtë rast shihet qartë se është bërë thyerja e heshtjes zgjedhore, e përcaktuar me LZP-në, rregullat zgjedhore dhe Kodin e Mirësjelljes së partive politike. Paraqitësi i ankesave si prova për pretendimet e tyre ka bashkangjitur ankesave disa fotografi lidhur me rastet në fjalë.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale - fotografive të bashkangjitura, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara, për këto arsye:

Paneli paraprakisht ka vlerësuar se ankesat: Anr.240/2019, Anr.253/2019, Anr.254/2019, Anr.258/2019, Anr.263/2019, Anr.272/2019, dhe Anr.274/2019, të gjitha me datë 05.10.2019, janë të njejta për nga përmbajtja, për nga natyra e shkeljes së pretenduar, dhe janë paraqitur

kundër subjektit të njëjtë politik, andaj paneli bazuar në nenin 8 paragrafi 3 i Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: “Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vend marrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim”, bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim të vetëm.

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesave në mbështetje të pretendimeve për ankesat, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se shkelësit e supozuar me datë 05.10.2019, e kanë vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore në rrjetin social “Facebook”, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore.

Nga provat e ofruara nga ankuesi, nuk mund të vërtetohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se reklamat e shkelësve të supozuar janë publikuar apo kanë vazhduar sponsorimet e fushatës zgjedhore edhe në ditën e heshtjes zgjedhore, sepse me asnjë provë shkresore nuk është argumentuar data dhe ora e reklamave të shkelësve të supozuar siç pretendohet në ankesa.

Ditën e shqyrtimit të këtyre ankesave, paneli ka hetuar nëse sponsorizimet e supozuara janë aktive por që nuk ka qenë e mundur të vërtetohet në rrugë elektronike nëse të njëjtat një ditë më parë kanë qenë aktive dhe në kohën e testimit të njëjtat kanë qenë jo aktive.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.240/2019 më datën 07.10.2019

Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, në kuptim të nenit 118 paragrafi 4 i LZP-së.